



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.03.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.03.2017 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"Viva Print&Drini Company"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"**, me Nr. të Prok: 616 -17-2458-521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **"Viva Print&Drini Company"** e datës 03.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"**, me Nr.616 17 2458 521 Nr. Brendshëm 616 17 063 521 kundër [Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK –së, të datës te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Vërtetohet vendimi i AK për dhënie e kontratës të publikuar me datë: 26.02.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"Viva Print&Drini Company"** me datë 03.03.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"** me Nr. të Prok: 616 17 2458 521; me Nr. te brendshem te prokurimit: 616 17 063 521 Autoriteti Kontraktues, me datë 05.12.2017, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kerkesës per rishqyrtim janë të pabazuara, duke u bazuar ne faktet që i paraqesim në vazhdim:

-Parashtruesi i kerkeses ka parashtruar ne OSHP ankesen e vet me daten 21.09.2017 me numer 350/17 dhe per te njejtin aktivitet ankese ka parashtruar edhe OE-ik"RSM"(numer 338/17). Bazuar ne keto ankesa eksperti shqyrtues ka dorezuar ekspertizen e vet me date

08.10.2017, ne te cilen ne menyre detale ka paraqitur konstatimet e veta lidhur me te gjitha pretendimet e parashtrueseve te ankesave. Nje nga pretendimet e OE-ik "RSM" ka qene se OE-ik "Viva Print&Drini Company" nuk eshte i pergjegjshem pasi qe nuk ka dorezuar deshmi se OE-ik "Botek" eshte distributor per prodhimet "3M". Ky pretendim ne ekspertize eshte trajtuar si i bazuar dhe sipas te ciles eksperti shkruan se "rezulton se ky OE-ik nuk ploteson kerkesen e specifikimit teknik kum kerkohet autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar. Me ekspertizen jemi pajtuar te gjithe:ne si Autoritet Kontraktues dhe parashtruesit e ankesave "RSM" dhe "Viva Print&Drini Company". Bazuar ne pajtimin e te gjitheve OSHP-ja me daten 16.10.2017 ka sjell Njoftimin-Vendimin numer 338/17&350/17 ne baze te te cilit lenda eshte kthyer ne rivleresim

-Autoriteti Kontraktues ka kryer rivleresimin ne harmoni te plote me konstatimet e ekspertizes dhe ne baze te te njejtës tenderi i OE-ik "Viva Print&Drini Company" eshte vleresuar si i pa pergjegjshem pikerisht duke u bazuar ne rekomadimet e ekspertizes. Parashtruesi i kerkeses per rishqyrtim nuk ka parashtruar ankese lidhur me rivleresimin, sigurisht duke u bazuar ne faktin se eshte pajtuar me ekspertizen, ndersa pretenduesi tjeter "RSM" ka parashtruar ankese me pretendimin se OE-ik i propozuar per dhenje te kontrates duhet te deshmoje edhe njehere se ka autorizime origjinale nga prodhuesi "Tamburrini Alesandro" dhe "Nuova Maric". Ne rivleresimin e ri kemi kerkuar drejtperdrejt nga prodhuesit qe te konfirmojne origjinalitetin e autorizimeve dhe kemi pergjegjen e tyre se ato jane origjinale dhe vlejne edhe me tutje. Ne baze te ketyre konfirmimeve kemi konfirmuar se vertetojme propozimin per dhenje te kontrates dhe ju jeni njoftuar se edhe me tutje jeni i pa pergjegjshem duke u bazuar ne ekspertizen paraprake te cekur më larte dhe pajtimin tuaj me të njejtën.

Bazuar në atë që u cek më lartë ju sqarojmë se ju vet jeni pajtuar me konstatimet e ekspertit në bazë të të cilave tenderi juaj është konsideruar i pa përgjegjshëm dhe nuk keni bazë ligjore për të kontestuar të njejtat.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Shtesë:

Vendimi i OSHP-se numer 508/17 dhe
Njoftimi dhe ekspertiza numer 338/17 dhe 350/17



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit